- vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më pak se 2%, por korigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.

2. Kur autoritetet /entet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.

- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

#### **O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

## **D. DHËNIA E KONTRATËS**

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
  - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
  2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
    - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
    - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
    - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
    - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
    - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër  
(Pas procesit të ankimit)

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontratës;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

|   |  |
|---|--|
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |  |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |  |
| <b>Vula</b>                               |  |
| <b>Datë _____</b>                         |  |

---

**Shtojca 2.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Data:** \_\_\_\_\_



Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: \_\_\_\_\_

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):  
\_\_\_\_\_

Monedha: \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

#### Lista e Çmimeve

| <i>1</i>                                  | <i>2</i>                                   | <i>3</i> | <i>4</i>        | <i>6</i>                         |         |
|---|--|----------|-----------------|----------------------------------|---------|
| Artikulli                                 | Përshkrimi i shërbimit                     | Sasia    | çmimi për njësi | Çmimi total për shërbim (3 x 4X) | Afati   |
| 1.  | Kartele per Grupin II te sigurimit teknik  | 2,688    |                 |                                  | 36 muaj |
| 2.  | Kartele per Grupin III te sigurimit teknik | 5,193    |                 |                                  | 36 muaj |
| 3.  | Kartele per Grupin IV te sigurimit teknik  | 3,858    |                 |                                  | 36 muaj |
| 4   | Kartele per Grupin V te sigurimit teknik   | 822      |                 |                                  | 36 muaj |
|   |  |          |                 | <b>Çmimi total (Mallrat)</b>     | _____   |
| <b>Çmimi Neto pa TVSH</b>                 |  |          |                 |                                  |         |
| <b>TVSH (%)</b>                           |  |          |                 |                                  |         |
| <b>Çmimi total me TVSH:</b>               |  |          |                 |                                  |         |
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |  |          |                 |                                  |         |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |  |          |                 |                                  |         |
| <b>Vula</b>                               |  |          |                 |                                  |         |
| <b>Datë</b> _____                         |  |          |                 |                                  |         |

---

**Shtojca 3.**

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|--|--|
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

---

**Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor* ]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

**SHËNIM:** Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

**Shërbimi që kërkohet:** "Paisja me kartela të sigurimit teknik për punonjësit të OSSH sh.a, për 36 muaj"

**Afatet e ekzekutimit:** 36 muaj.

**Sasia e mallit që kërkohet:**

| 1  | 2  | 3     | 4           | 5           | 6       |
|----|--|-------|-------------|-------------|---------|
| Nr | Përshkrimi i Shërbimeve                    | Sasia | Çmimi Njësi | Çmimi Total | Afati   |
| 1  | Kartele per Grupin II te sigurimit teknik  | 2,688 |             |             | 36 muaj |
| 2  | Kartele per Grupin III te sigurimit teknik | 5,193 |             |             | 36 muaj |
| 3  | Kartele per Grupin IV te sigurimit teknik  | 3,858 |             |             | 36 muaj |
| 4  | Kartele per Grupin V te sigurimit teknik   | 822   |             |             | 36 muaj |
|    |  |       |             |             |         |

---

## Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Specifikimet teknike të hartuara:

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

**Objekti dhe qëllimi: "Paisja me kartela te sigurimit teknik per punonjesit te OSSH sh.a, per 3 vjet":**

#### **1. Te Pergjithshme**

- b. Paisja me dëshmi aftësie të sigurimit teknik të personelit të kompanisë Ossh Sh.a kryhet në detyrim të ligjit nr.8734, datë 01.02.2001 " Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike" (i ndryshuar), përkatësisht neni 9,pika 1, germa a ku thuhet: "Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse", si dhe në mbështetje të pikës 1-3, germa b, të Rregullores së Sigurimit Teknik për pajisjen me dëshmi aftësie të sigurimit teknik.

Procesin e pajisjes me dëshmi aftësie e kryejnë trupat e akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit. Keto trupa duhet të zotërojnë një Çertifikatë Akreditimi në përputhje me standartin **S SH EN ISO/IEC 17024:2012** "Vlerësimi i konformitetit – Kërkesa të përgjithshme për trupat që kryejnë certifikim personeli"

#### **1. Objektivat kryesore**

Zbatimi i shërbimit të pajisjes me dëshmi aftësie të sigurimit teknik të personelit të Ossh Sh.a, përveç faktit që është i detyrueshëm me ligj dhe moszbatimi i tij përben kundrtavajtje administrative ka si objektiva kryesore :

- Kontrollin e njohurive të teknikes së Sigurimit Teknik të punonjësve të kompanisë.
- Rritjen e masave teknike dhe organizative të marra gjatë punës;
- Klasifikim i personelit në bazë të grupit të kualifikimit të sigurimit teknik.
- Nxitjen e personelit për zhvillimin e njohurive dhe rregullave të sigurimit teknik për shfrytëzimin e impianteve dhe pajisjeve elektrike.
- Rritjen e sigurisë së punës të personelit i cili ndërton, shërben dhe kryen punime në impiantet dhe instalimet elektrike që ndërtohen dhe janë në shfrytëzim.

---

## ***2. Pamje e përgjithshme e shërbimit të pajisjes me dëshmi aftësie të sigurimit teknik***

Pajisja me dëshmi aftësie të sigurimit teknik të personelit të kompanisë OSSH.SHA. është në detyrim të ligjit nr.8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” (i ndryshuar). Gjithashtu, procesi i pajisjes me dëshmi aftësie monitorohet dhe nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial.

### ***KERKESA TEKNIKE DHE FUNKSIONALE TE PAJISJES ME DESHMI AFTESIE***

#### ***Pajisja me dëshmi aftësie të sigurimit teknik të personelit të kompanisë OSSH SHA.***

Pajisja me dëshmi aftësie të sigurimit teknik është një proces që kryhet nga trupat e akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit. Këto trupa zotërojnë një Çertifikatë Akreditimi në përputhje me standartin **SSH EN ISO/IEC 17024:2012** “Vlerësimi i konformitetit – Kërkesa të përgjithshme për trupat që kryejnë certifikim personeli”.

Pajisja me dëshmi aftësie të sigurimit teknik është i detyrueshëm për çdo punëmarrës të kompanisë, i cili ndërton, shërben dhe kryen punime në impiantet dhe instalimet elektrike që ndërtohen dhe janë në shfrytëzim. Ky detyrim lind në zbatim të ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” (i ndryshuar), përkatësisht nëni 9, pika 1, gërma a ku thuhet: “Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrësit që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse”, si dhe në mbështetje të pikës 1-3, gërma b, të Rregullores së Sigurimit Teknik.

Moszbatimi i këtij detyrimi ligjor përben kundrravajtje administrative dhe shoqërohet me gjore nga insitucionet përkatëse të cilat monitorojnë dhe mbikqyrin procesin e pajisjes me dëshmi aftësie të sigurimit teknik.

Procesi i pajisjes me dëshmi aftësie të sigurimit teknik të kompanisë zhvillohet nga trupa e akredituar për certifikimin e personelit. Ky proces organizohet nga këto trupa, të cilat, në bazë të kërkesave të drejtorive përkatëse të kompanisë për personelin i cili duhet të kryejë provimin e sigurimit teknik, organizojnë ditën dhe vendin ku do të zhvillohet testimi i njohurive të personelit përkatës. Testimi i personelit kryhet nga pjestarët e stafit të trupës së akredituar, të cilët me patjetër duhet të jenë të diplomuar në degën Inxhinieri Elektrike.

Pjesëmarrësit në provimin e sigurimit teknik si dhe rezultatet e testimit të sigurimit teknik mbahen në procesverbalet përkatëse, në fund të të cilit nënshkruajne anëtarët e komisionit të trupës që kryen marrjen në provimin e sigurimit teknik të personelit të kompanisë, si dhe përfaqësuesi i caktuar i kompanisë, i cili është prezent gjatë testimit.

Shoqëria jone ka **4187** punonjës të cilët do të nënshtrohen testimit për njohuritë e sigurimit teknik dhe do të pajisen me dëshmi aftësie të lëshuar nga trupa e akredituar sipas kategorive përkatëse.

Procesi i testimit kryhet duke marrë parasysh grupin e sigurimit teknik të çdo punonjësi. Grupi i sigurimit teknik përcaktohet në bazë të disa kritereve të punëmarrësit, ndër të cilat janë:

- a. Arsimi përkatës
- b. Kualifikimi
- c. Moshë
- d. Pozicioni i punës
- e. Eksperiencë e punës

---

Ne baze te Rregullores se Sigurimit Teknik, grupet e Sigurimit Teknik ndahen ne 5 (pese) kategori.

### **1. Grupi I i Sigurimit Teknik**

Punonjesit te cilet klasifikohen ne Grupin I te sigurimit teknik jane :

- Punonjesit e thejshte dhe nivel drejtues te cilet kane te drejte te hyjne ne impiante elektrike te shperndarjes .
- Punetore ndertimi
- Bojaxhi
- Nxenes ne ekonomi per elektriciste
- Praktikante
- Gjithe personeli i reparteve te tjera i cili nuk provohet per njohjen e rregullores se sigurimit teknik, si pastruesit e impianteve elektrike e mekanike, shoferet e ndermarjes elektrike

keto kategori punonjesish jane persona te cilet kane te bejne me sherbimin ne impiantet elektrike, por qe nuk kane njohuri mbi rrezikun nga rryma elektrike dhe mbi masat e sigurimit per punimet ne impiantet dhe pajisjet elektrike.

### **2. Grupi II i Sigurimit Teknik**

Punonjesit te cilet klasifikohen ne Grupin II te sigurimit teknik jane :

- Praktikante te teknikumeve te mesme industriale
- Kontrolloret e linjave
- Bojaxhinjte e shtyllave elektrike
- Elektricistet me kategori te ulet
- Personeli elektromekanik, vincier.

Keto kategori punonjesish jane persona te cilet kane njohuri fillestare mbi impiantet elektrike. Njohuri te mjaftueshme per rrezikun ndaj rrymes elektrike dhe afrimi ne pjeset nen tesion. Njohuri te masave mbrojtese gjate punimeve ne pajisjet dhe impiantet elektrike. Njohuri praktike mbi rregullat e dhenie se ndihmes se pare.

### **3. Grupi III i Sigurimit Teknik**

Punonjesit te cilet klasifikohen ne Grupin III te sigurimit teknik jane :

- Personeli i nderreses ne central dhe nenstacion, impiantet e shperndarjes dhe rrjetit elektrik
- Telefonist, dispecer ne ndermarjet elektrike
- Elektricist me njohuri te mjaftueshme per impiantet elektrike dhe me arsim profesional.

Keto kategori punonjesish jane persona te cilet kane njohuri te plota mbi konstruksionet, impiantet dhe linjat elektrike. Njohuri te plota mbi rrezikun gjate punimeve ne impiantet dhe linjat elektrike. Njohuri te masave mbrojtese gjate punimeve ne pajisjet dhe impiantet elektrike. Njohuri praktike mbi rregullat e dhenie se ndihmes se pare. Njohuri mbi lejimin e brigadave ne punimet elektrike. Njohuri te rregullave te vecanta te sigurimit teknik ne baze te punes qe ato kryejne. Te dije te ushtroje kontroll mbi punonjesit qe kryejne punime ne impiantet dhe linjat elektrike.

### **4. Grupi IV i Sigurimit Teknik**



---

Punonjesit te cilet klasifikohen ne Grupin IV te sigurimit teknik jane :

- Mjeshtra, montier dhe elektromontier te personelit te nderreses ne centrale, nenstacione dhe i rrjetit elektrik.
- Teknike dhe inxhinier te rinj.

Keto kategori punonjesish jane persona te cilet kane njohuri te plota elektroteknike. Njohuri te plota te sigurimit teknik. Njohuri te plota te perdorimit te mjetyeve mbrojtese ne pune. Njohuri te plota te caktimit te detyrave te brigades ne pune. Njohuri te rregullave te vecanta te sigurimit teknik ne baze te punes qe ato kryejne. Te dije te ushtroje kontroll mbi punonjesit qe kryejne punime ne impiantet dhe linjat elektrike. Njohuri praktike mbi rregullat e dhenie se ndihmes se pare.

### **5. Grupi V i Sigurimit Teknik**

Punonjesit te cilet klasifikohen ne Grupin V te sigurimit teknik jane:

- Mjeshtrat qe kane mbi 10 vjet pune dhe 3 vjet me grupin IV te sigurimit teknik.
- Tekniket qe kane mbi 10 vjet pune dhe 3 vjet me grupin IV te sigurimit teknik
- Inxhinieret elektrik.

Keto kategori punonjesish jane persona te cilet kane njohuri te plota elektroteknike. Njohuri te plota te sigurimit teknik. Njohuri te plota te perdorimit te mjetyeve mbrojtese ne pune. Njohuri te plota te caktimit te detyrave te brigades ne pune. Njohuri te rregullave te vecanta te sigurimit teknik ne baze te punes qe ato kryejne. Te dije te ushtroje kontroll mbi punonjesit qe kryejne punime ne impiantet dhe linjat elektrike. Njohuri praktike mbi rregullat e dhenie se ndihmes se pare. Njohjen e plote te skemes se impiantit, karakteristikat e pajisjes.

## **MODELI I LIBREZES SE SIGURIMIT TEKNIK**

Pas kalimit te testimit per njohurite e rregullores se sigurimit teknik, cdo punemarres pajiset me librezën e sigurimit teknik.

Formati i librezes se sigurimit teknik percatohet nga trupa e akredituar, e cila kryen testimin e personelit per njohurite e sigurimit teknik.

Libreza e cila leshohet nga trupa certifikuese e personelit permban:

- Te dhenat personale te punemarresit i cili pajiset me librezën (deshmine) e aftesise perkatese
- Profesioni
- Kualifikimi
- Vjetersia ne pune
- Grupin e sigurimit teknik per te cilin eshte kualifikuar
- Data e daljes ne testimin e sigurimit teknik
- Nenshkrimi (miratimi) i komisionit te marrjes ne provimin e sigurimit teknik

**Testimi i punonjesve do te zhvillohet prane Drejtorive Rajonale/Njesive dhe Drejtorise se Tensionit te Larte/Njesive TL, prane se cilave punonjesit jane te punesuar.**

**Sasia e parashikuar dhe afati i levrimit per kartela.**

---

| <b>Nr</b> | <b>Përshkrimi i Shërbimeve</b>             | <b>Sasia</b> | <b>Afati</b> |
|-----------|--|--------------|--------------|
| 1         | Kartele per Grupin II te sigurimit teknik  | 2688         | 36 muaj      |
| 2         | Kartele per Grupin III te sigurimit teknik | 5193         | 36 muaj      |
| 3         | Kartele per Grupin IV te sigurimit teknik  | 3858         | 36 muaj      |
| 4         | Kartele per Grupin V te sigurimit teknik   | 822          | 36 muaj      |

**Afatet e ekzekutimit: 36 muaj**

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pushyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

#### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

---

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

---

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **44,292,360 (dyzet e katër milion e dyqind e nëntëdhjetë e dy mijë e treqind e gjashtëdhjetë)** leke pa TVSH.

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse (*Administrata tatimore*) dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 17,716,000 (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) leke pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

### 2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare me:

- a) ISO 9001:2015 ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme);
- b) ISO 45001-2018 ose ekuivalente, mbi “Standartet e sigurise ne pune” (e vlefshme);

*Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.*

*Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.*

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **Çertifikatën e Akreditimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit**, në përputhje me standartin S SH EN ISO/IEC 17024:2012 “Vlerësimi i konformitetit – Kërkesa të përgjithshme për trupat që kryejnë certifikim personeli elektrik”, e cila duhet të perkojë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen.

2.3.4 Ofertuesi të paraqesë formatin e librezes së sigurimit teknik, me të cilën do të pajisën personeli i kompanisë i cili do të rezultojë kalues në testimin e njohurive të sigurimit teknik.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 12 punonjës, ku përfshihen edhe minimalisht të paktën (tete) inxhinier elektrik të pajisur me Diplome, ku 4 (kater) Inxhinierë të jenë minimalisht me eksperience pune mbi 15 (pesëmbëdhjetë) vjeçare dhe të paktën mbi 5 vjet në fushën e certifikimit të personelit elektrik, që do të angazhohen për marrjen në provimin e sigurimit teknik të personelit.

Kjo të vertetohet me dorëzimin e:

- Listë pagesat për muajin e Gushtit 2024;
- Vertetim nga tatimet ku të pasqyrohet numri i punonjësve;
- CV të personelit që do të angazhohet për kryerjen e këtij lloji shërbimi, diplomat e tyre përkatëse dhe libeze pune.

**Sqarim :** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).*

**Shenim :** Sqarime të gjithë operatorët ekonomik që në rast mosperputhje ndërmjet versionit anglisht të DT dhe atij në shqip, do të prevalojë versioni shqip i DT.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

## FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

- I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

| Identifikimi   | Përgjigja  |
|--|------------|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE) | -----      |
| Numri NIPT/et:   | -----      |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar  | -----      |
| Përfaqësuesi (emri):   | -----      |
| Telefoni:  | -----      |
| E-mail:  | -----<br>- |

**B: DEKLARATË**

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

| Emri i nënkontraktorit të propozuar | NIPT -i | Përqindja e nënkontraktimit | Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar |
|-------------------------------------|---------|-----------------------------|---|
|                                     |         |                             |   |
|                                     |         |                             |   |
|                                     |         |                             |   |

**Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatorin ekonomik**

| Emri (at) e subjekteve | NIPT-i | Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik | Specifiko konkretisht kapacitetin/et |
|------------------------|--------|--|--------------------------------------|
|                        |        |  |                                      |
|                        |        |  |                                      |
|                        |        |  |                                      |

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

| Deklarata  |
|--|
| <p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>  |
| <p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>   |
